



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:151362

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05676628

**C.nr.549/21**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri me bashkëpunëtorin profesional Liman Javori, në çështjen juridike të paditësit X. K.nga fshati B./Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson Agron Kryeziu avokat nga Malisheva, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik i komunës Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike për kompensimin shujtave ditore, vlera e kontestit 152.00 €, jashtë seancës gjyqësore me datë 13.05.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit X. K.nga fshati B./Malishevë dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shujtës ditore të përlloritur për periudhën nga data 02.09.2019 deri më datë 24.06.2022, ose për gjithsejtë 76 ditë pune, t'ia paguaj nga dy (2) euro në ditë, ose shumën e përgjithshme prej 152.00 euro me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë me datë 05.07.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm
- II. **OBLIGOHET** e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 99.00 euro (nëntëdhjetë e nëntë euro) dhe atë, në emër të përpilimit të padisë shumën prej 78.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

*Pretendimet e palëve:*

Paditësi X. K.nga fshati B./Malishevë përmes të autorizuarit të tij Agron Kryeziu avokat nga Malisheva, në këtë gjykatë me datë 05.07.2021 ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave me vlerë të kontestit 500 euro. Sipas padisë, paditësi është i punësuar në SHFMU “Dëshmorët e fshatit Bubavec” sipas kontratës së punës dhe ka 3 vite përvojë pune, ndërsa sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë me nenin 35 par.7 i takon e drejta e kompensimit për shujta lidhur me ditët e punës.

Ka shtuar se paditësi ka paraqitur kërkesë tek e paditura për pagesën e shujtave, por ende nuk ka pranuar përgjigje, andaj lidhur me këtë ka kërkuar nga gjykata që të nxjerrë aktgjykim me të cilin do të aprovohej padia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që t'ia paguaj shpenzimet për shujta ditore sipas formulës 21 ditë pune x 2 euro = 42 euro për çdo muaj.

I autorizuari i paditësit, përmes parashtrës së datës 05.05.2023 ka bërë precizimin e padisë duke theksuar se pas pranimi të vërtetimit të shkollës, paditësi ka bërë precizimin e ditëve të punës dhe tani ka theksuar se për periudhën 02.09.2019 deri me 24.06.2022 i ka gjithsejtë 76 ditë pune, dhe duke e llogaritur një ditë pune me 2 euro për shujtë ditore, atëherë shuma e përgjithshme është 152 euro, andaj ka kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit, dhe të detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të shujtës ditore për 76 ditë pune, t'ia paguaj paditësit shumën e përgjithshme prej 152 euro, me kamatë ligjore prej 8% prej datës së paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, për precizimin e kërkesëpadiës shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 21 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së saj në padi dhe precizim të padisë të datës 18.08.2023, ndër të tjera ka theksuar se e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi që kontrata e arsimit e lidhur mes SBASHK dhe MASHT është shkëputur dhe kjo Kontratë Kolektive tani më nuk është në fuqi dhe se palët që e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet dhe i ka munguar baza ligjore.

Po ashtu MAPL ka bërë njoftimin për kryetarët e komunave me datë 22.11.2022 për shkëputjen e Kontratës nga MASHT për mungesë të bazës ligjore dhe meqenëse kjo kontratë më nuk është në fuqi, komuna e Malishevës-DKAE lidhur me këtë çështje kontestuese, nuk ka legjitimitet të palës aktive, por këtë legjitimitet e ka MASHT.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj padinë e paditësit si të pabazuar, ose këtë çështje kontestuese ta zhvilloj ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës-MASHT.

### Provat e administruara dhe vlerësimi

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto prova dhe atë: Kërkesën e paditësit drejtuar të paditurës për pagesën e shujtave nr. ... të datës 30.06.2021, përgjigjen e të paditurës nr.... të datës 02.07.2021, vërtetimet mbi marrëdhënien e punës, përvojën e punës dhe prezencën në punë: nr.

... të datës 25.02.2020, nr.... të datës 02.08.2020 nr. prot.... të datës 20.04.2023 dhe kontratën e punës me nr. prot.... të datës 07.09.2018.

Ndërmjet palëve nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura dhe atë mësimdhënës i lëndës ë TIK-ut në SHFMU “Dëshmorët e Fshatit Bubavec” në Bubavec, shkollë kjo e cilat bie në kompetencë të të paditurës dhe kjo është vërtetuar me kontratën e punës nr. prot.... të datës 07.09.2018.

Nga vërtetimet e cekura më lart të lëshuara nga Drejtoria e shkollës, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, ka përvojë të punës 2 vite e 10 muaj dhe për periudhën 02.09.2019 deri me 24.06.2022 ka qenë prezent në punë gjithsejtë 76 ditë.

Në bazë të kërkesës së paditësit dhe përgjigjes së të paditurës, vërtetohet fakti se paditësi ka bërë kërkesë për kompensimin e shujtave, kurse e paditura e ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se komuna e Malishevës nuk është palë në marrëveshje dhe Qeveria nuk ka planifikuar buxhet.

#### Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kontrata e punës dhe vërtetimet lëshuara nga e paditura të cekura më lart, gjykata i ka pranuar si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj, kontratës së punës dhe vërtetimeve me të cilat është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe për periudhën e cekur ka realizuar 76 ditë pune, gjykata ua fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Sipas nenit 8 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve “*Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre*” ndërsa në dispozita e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se: “*Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit, e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë*”, kurse me Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90/01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shpenzimeve

të shujtave për ditët prezent në punë, u vendos që të njëjtën ta aprovoj për periudhën e kërkuar nga 02.09.2019 deri me 24.06.2022, gjatë së cilës periudhë, paditësi ka punuar tek e paditura, fakt ky që u vërtetua edhe nga vërtetimet e lartcekura dhe në këtë gjendje të vërtetuar faktike, e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata ka gjetur se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr. 2056 të datës 18.04.2017 e cila ka qenë në fuqi deri me datën 21.01.2021, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.105 të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datën 21.11.2022 kur edhe është anuluar nga MASHT, ku me nenin neni 35 par.7 përcaktohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*, andaj kjo gjykatë vlerëson se paditësit i takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore për ditët e pranisë në punë, përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u nisur nga fakti se e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e saj që del nga po e njëjta kontratë kolektive, përkatësisht neni 35 par.7, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj në rastin konkret gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Sa i përket lartësisë së shumës, gjykata u bazua në vërtetimin me nr. prot. ... të datës 20.04.2023, me anë të të cilit vërtetohet se paditësi për periudhën nga data 02.09.2019 deri më datë 24.06.2022, ka qenë prezent në punë gjithsejtë 76 ditë, ashtu që vendosi si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se për këtë periudhë, paditësit i takojnë shpenzimet për shujtë ditore në shumën e përgjithshme prej 152.00 euro, duke e llogaritur 2 euro për një ditë pune (2 euro x 76 ditë pune = 152 euro). Pra, në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e udhëtimit për ditët sa ka qenë prezent në punë.

Lidhur me kundërshtimet e të paditurës në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike me të cilën do të duhej të refuzohej kërkesëpadia e paditësve. Pretendimet e të paditurës se i mungon legjitimiteti pasiv në procedurë me arsyetimin se Kontratën Kolektive të Arsimit e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, është e pabazuar sepse e njëjta prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë.

E paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet edhe në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa me dispozitën e par.1.2 përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*.

Në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësve (mësimdhënësve) dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë në raport me të punësuarit e saj në arsim. Pretendimet e të paditurës se Kontrata Kolektive është shkëputur dhe nuk prodhon efekt juridik nuk kanë mbështetje ligjore, për faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 ka qenë në fuqi deri me datën 21.01.2021, kurse Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 ka qenë në fuqi deri me datën 21.11.2022 kur edhe është anuluar nga MASHT, kjo bazuar edhe në Mendimin Juridik për Shpërblimin Jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr.40/2023 të datës 27.02.2023.

Gjykata ka analizuar edhe pretendimet tjera të të paditurës, mirëpo ka vlerësuar se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe sikurse është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (05.07.2021), dhe bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën -II- të dispozitivit, gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe nenit 453 par.1 dhe 2 të LPK-së ku parashihet se: *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”*, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, e cila rregullore përcakton se përpilimi i padisë në kontestet e vlerës së vogël (nën 500.00 euro, siç është në rastin konkret) është në shumën prej 78.00 euro, ashtu që vendosi që paditësit t’ia njoh shpenzimet e procedurës duke e detyruar të paditurën që t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 99.00 euro dhe atë në emër të parashtrimit të padisë shumën 78.00 dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro, ndërsa kërkesa përtej kësaj shume është refuzuar, sepse me

parashtrësën për precizim, paditësi vetëm i ka precizuar ditët e punës dhe periudhën për të cilën e ka kërkuar kompensimin dhe se këtë saktësim/precizim ka mundur ta bëjë edhe me padi, prandaj nuk mund të detyrohet pala e paditur për shpenzime të cilat janë krijuar me fajin e vet paditësit.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 398 lidhur me nenin 142 të LPK-së, si dhe nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, lidhur me nenin 35.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.549/21 me datën 13.05.2024**

**Gj y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.